

FJALA PËRSHËNDETËSE

Ilir Meta
Kryeministër

Të nderuar miq dhe të ftuar,

Zonja dhe Zotërinj,

Dhjetë vjet më parë, ndarja e pakthyeshme e shoqërisë shqiptare nga autarkia dhe regjimi totalitar bëhej nën moton më të qartë politike, ndoshta më të qartë se kudo në vendet që përjetonin përmbysje të ngjashme "E duam Shqipërinë si gjithë Europa". Ato momente dhe hapa që pasuan, treguan se qytetarët e këtij vendi, ndonëse të lodhur deri në deformim fizik e shpirtëror, nga një prej diktaturave më të egra që ka njohur bota, kishin ruajtur, thuajse të paprekur, besimin dhe vokacionin e tyre të natyrshëm europian.

Por, nga ana tjetër, dhjetë vjet më parë, jo të gjithë kishin vetëdijen e plotë mbi ashpërsinë dhe kompleksitetin e reformave që do të duhej të ndërmerrem, të përgjegjësive që binin mbi secilin dhe të sakrificave që kërkoheshin ende.

Duke bërë, pa dyshim, zgjedhjen më të drejtë në historinë e saj, shoqëria shqiptare nuk do të mund të shkonte shumë larg, nëse nuk do të kapërcente shpejt iluzionet fillestare të konsumit imediat dhe të bashkëngjitjes mekanike me botën e zhvilluar dhe nuk do të përgatitej shpirtërisht për sfidat e një rruge të gjatë, të vështirë dhe ende me plot të panjohura për të.

Pikërisht, ky kalim nga dëshirat dhe vizioni europian, nga besimi dhe idealet e njerëzve, tek mekanizmi dhe instrumentet konkrete të tranzicionit, tek ai mekanizëm kompleks që do të transformonte rrënjësisht institucionet dhe marrëdhëniet ndërinstitutionale, legjislativën dhe modelin qeverisës, hapjen ndaj botës dhe daljen nga varfëria - përbënte edhe sfidën më të madhe dhe më të vështirë që qëndronte para nesh dhjetë vjet më parë. Brenda një kohe të shkurtër, ajo u shndërrua nga një çështje bindjeje e vendimi politik, në një çështje njohurish e kapacitetesh përvoje dhe burimesh.

As që mund të mendohet se kësaj përpjekjeje gjigande ne mund t'ia dilnim mbanë, pa hapin historik të nënshkrimit të marrëveshjeve me Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe Bankën Botërore, pikërisht dhjetë vjet më parë. Ai ishte nënshkrimi për një shoqëri të lirë, të hapur e demokratike, bazuar në konkurimin e vlerave dhe në ekonominë e tregut.

Vulosja e këtij partneriteti afatgjatë u bë kyçi i suksesit të reformave. Ajo mbetet garancia themelore e pakthyeshmërisë së procesit të modernizimit të Shqipërisë edhe në të ardhmen.

Natyrisht, bashkëpunimi ynë me institucionet e Bretton Woods-it nuk ishte një punë e lehtë. Në ditën e anëtarësimit, më 15 tetor 1991 ne vinim në këto institucione pas disa dekadash izolimi total dhe sulmi ideologjik ndaj imazhit të tyre, pa asnjë eksperiencë të mëparshme mbi rregullat dhe instrumentet e ekonomisë së tregut dhe kur vendi, si rezultat i transformimit radikal, kishte hyrë në një klimë tensionesh të mëdha sociale, pa folur për tensionet historike që shoqëronin atmosferën rajonale.

Çdo vështrim retrospektiv mbi rrugën e përshkuar në këto dhjetë vjet, pavarësisht nga kostot e gabimeve qeverisëse, kosto të cilat

vazhdojnë të paguhen edhe përmes mungesave të paneglizhueshme në jetën e përditshme, konfirmon jo vetëm se objektivi ynë ka qenë zgjedhur drejt dhe se aspirata jonë demokratike dhe integruese vazhdon të gëzojë konsensusin më të gjerë në të gjithë spektrin e shoqërisë shqiptare. Ai dëshmon, para së gjithash, efikasitetin e punës sonë qeverisëse se ne kemi ditur të zgjedhim politikat dhe instrumentet e duhura administruese dhe kemi vëmendjen t'i përsosim ato vazhdimisht. Por, ai tregon edhe se bashkëpunimi ynë me partnerët ndërkombëtarë, jo vetëm me Fondin Monetar Ndërkombëtar e Bankën Botërore, por edhe me Bashkimin Europian, me SHBA-në e me qeveritë e vendeve të tjera mike dhe institucionet ndërkombëtare, ka qenë efektiv.

Qysh nga 15 tetori 1991, data kur Shqipëria u bë zyrtarisht anëtare e FMN-së, e deri më sot, bashkëpunimi ynë ka kaluar përmes tre programesh trevjeçare, të modeluara për t'ju përgjigjur situatave që kalonte vendi në stadin e dhënë të reformave. Kështu, marrëveshja e parë "stand by", me shtrirje deri në korrik 1993, kontribuoi dukshëm në frenimin e rënies ekonomike dhe shmangien e kolapsit, pas një ndërrimi të menjëhershëm të sistemit. Ajo u shoqërua me dy marrëveshje të njëpasnjëshme ESAF (Enhanced Structural Adjustment Facility) të cilat formuan platformën e reformave bazë strukturore në ekonomi dhe në forcimin institucional, duke i hapur rrugën financimeve të Bankës Botërore dhe agazhimit të shumë donatorëve të tjerë.

Qysh atëherë e deri më sot, Shqipëria, sipas marrëveshjeve edhe të vet partnerëve tanë, është përpjekur të marrë dhe të përballojë të gjitha përgjegjësitë.

Mbyllja e qindra fabrikave jorentabël, privatizimi i shpejtë, kontrolli i rreptë mbi pagat dhe pensionet, kontrolli ndaj deficitit buxhetor dhe borxhit të jashtëm, shtrirja e skemës dhe peshës tatimore etj., janë gurë të rëndësishëm kilometrikë në konsolidimin social-ekonomik, por edhe sakrificat jo të vogla për qeveritë dhe sidomos për jetën e njerëzve.

Tronditja më e thellë që shoqëria shqiptare dhe ju, të nderuar partnerë, përjetuat së bashku me ne, në këtë dhjetëvjeçar, mbetet pa dyshim kriza e rëndë që shoqëroi kolapsin e skemave piramidale në vitin 1997. Por, aq sa e rëndë ishte pesha e kësaj krize, aq sa të rënda ishin pasojat e kaosit që shoqëroi falimentimin e shtetit, po aq lartësohet edhe puna jonë e përbashkët e këtyre viteve për kapërcimin me sukses të gjendjes dhe kalimin nga humnera në një konsolidim shembullor.

Ne sot kemi pa dyshim një shoqëri, një shtet e një qeveri shumë më të emancipuar e të konsoliduar edhe se sa disa vjet më parë. Shqipëria ka Kushtetutën e saj, një sistem të zhvilluar drejtësie dhe institucione të përgjegjshme për rolin e tyre.

Stabiliteti makroekonomik dhe ai makrofiskal që kemi arritur, rritja e qëndrueshme e me ritme të larta e prodhimit të brendshëm bruto, rritja e të ardhurave buxhetore dhe e aftësisë vetëfinancuese të ekonomisë, përsheptimi dhe efikasiteti i privatizimit, përmirësimet e vazhdueshme në rend e siguri, në infrastrukturë dhe në klimën e biznesit, në arsim, shëndetësi dhe kujdesin social etj., tregojnë se programi ynë nuk orientohet nga objektiva abstraktë ideologjike dhe se orientimi ynë themelor mbetet niveli i jetesës së shqiptarëve, përmes adoptimit me standardet dhe vlerat më të përparuara euroatlantike.

Ne kemi sot një buxhet mjaft të balancuar, i cili tashmë hartohet edhe në një kuadër afatmesëm. Deficiti i përgjithshëm vetëm në tre vitet e fundit është ulur nga 10.5 për qind, në 9.2 për qind (i pritshmi i vitit 2001). Të ardhurat fiskale gjithsej nga 12 për qind të prodhimit të brendshëm bruto, arritën në 16 për qind, duke u dyfishuar në vlerë absolute vetëm brenda tre vjetësh.

Infrastruktura jonë rrugore, nacionale dhe urbane, me gjithë mangësitë e njohura, as që ka të krahasuar me atë të vetëm disa viteve më parë. Privatizimi ka përsheptuar ritmet dhe, i shtrirë me shpejtësi në sektorët strategjikë, po shoqërohet me efekte financiare shumë të larta. Puna e Administratës Publike bazohet tashmë në një kuadër ligjor modern, baza e të cilit është ligji " Për shërbimin civil".

Shumë më i rëndësishëm se sa ndryshimet e infrastrukturës fizike të vendit, është ndryshimi i thellë që ka ndodhur në mentalitetin e njerëzve, duke bërë që individit e komuniteti të marrin më shumë përgjegjësi dhe që sjellja sociale të zhvillohet në një linjë me kërkesat e reformave dhe të modelit politiko-ekonomik që aspirojmë. Kësaj i shërben më së miri edhe reforma për decentralizimin e mëtejshëm të pushtetit dhe ligji për pushtetin lokal. Natyrisht zonja dhe zotërinj, jo gjithçka në punën tonë shkon më së miri. Ne jemi të vetëdijshëm për problemet që shfaq dhe pasojat që vijnë nga dobësitë në sektorin energjistik.

Duke njohur si shkak kryesor neglizhencën më se pesëmbëdhjetëvjeçare në këtë sektor, mungesën e jashtëzakonshme të rreshjeve dhe konsumin e shumëfishuar, ne nuk kemi qëndruar aspak duarkryq. Studimi serioz dhe plani i

veprimet afatmesëm, i hapën rrugën zhblokimit të paketës financiare të donatorëve në këtë sektor, të cilët përfitoj nga rasti t'i falenderoj edhe një herë përzemërsisht për kontributin e tyre.

Monitorimi i vazhdueshëm i këtij sektori dhe sforcot për normalizim të shpejtë, ndoshta, përbëjnë preokupimin kryesor të punës sonë të përditshme. Këto sforcot përfshijnë masa të gjithanshme, që nga përsosja e administrimit të KESH-it, e deri tek inkurajimi i përdorimit të burimeve të energjisë nga konsumatorët. Rritja e çmimit të energjisë, që aplikuam së fundi, përbën një masë të domosdoshme, edhe pse me një kosto social-politike që jemi të vendosur ta përballojmë.

Sidoqoftë, në tërësinë e tyre, treguesit e arritur na japin më shumë siguri e motivim për të vazhduar më shpejt e më me vendosmëri në rrugën reformuese e integruese, e për t'i mbyllur çdo shteg përpjekjeve destabilizuese e papërgjegjshmërive politike ngado që të vijë, e që vazhdojnë të mbeten një kërcënim real për stadin e sotëm. Garanci për këtë janë edhe përpjekjet e përbashkëta për t'i dhënë zhvillimit të vendit një kuadër strategjik më të konsoliduar. Një muaj më parë, Komiteti i Politikave Ekonomike të Qeverisë Shqiptare miratoi Strategjinë Kombëtare të Zhvillimit Ekonomik e Social, të përgatitur me kontributin direkt të partnerëve tanë ndërkombëtarë. Kjo strategji siguron më në fund harmonizimin e plotë të strategjive sektoriale të përgatitura si ato të bujqësisë, turizmit dhe mjedisit, arsimit dhe shëndetësisë, energjitikës dhe furnizimit me ujë, mbështetjen e SME-ve, decentralizimin e pushtetit etj.. Ne jemi të vetëdijshëm se ky, sidoqoftë, përbën vetëm hapin e parë, për të mbështetur perspektivën e zhvillimit të vendit në vizione strategjike afatgjata.

Por, garancia më e madhe e vazhdueshmërisë së reformave mbetet pa dyshim procesi i Stabilizim Asocimit në rrugën e integritit tonë europian. Miratimi që presim pas disa ditësh i draft-mandatit për hapjen e negociatave lidhur me nënshkrimin, brenda vitit të ardhshëm, të Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit me Bashkimin Europian, materializon përfundimisht aspiratën europiane të shqiptarëve dhe do të jetë inkurajimi më i madh për përshtetimin e reformave tona në të gjithë sektorët.

Ne jemi të vendosur që kësaj rruge t'i shkojmë deri në fund, duke përmbushur të gjitha detyrimet që rrjedhin nga kjo marrëveshje. Hapat tanë në kapërcimin e paragjyqimeve dhe në forcimin e bashkëpunimit rajonal me fqinjët, roli që kemi luajtur në uljen e tensioneve dhe të krizave rajonale etj., dëshmojnë më së miri se Shqipëria ka adoptuar tashmë një qëndrim europian në këtë

çështje. Jam i bindur se në këtë rrugë ndihma e partnerëve tanë ndërkombëtarë nuk do të na mungojë.

Me këtë rast, dëshiroj të shpreh falenderimin dhe mirënjohjen tonë për të gjithë përfaqësuesit rezidentë të Fondit Monetar Ndërkombëtar dhe të Bankës Botërore, si dhe stafet e tyre, të cilët kanë punuar me përkushtim për përmbushjen e objektivave tanë të përbashkët.

Si Kryeministër i Shqipërisë, në dy mandatet e fundit të njëpasnjëshme, unë respektoj parimin se mandatet tona nuk duhen parë të shkëputura, por ato duhet të respektojnë vazhdimësinë e marrëveshjeve tona me partnerët.

Pikërisht, në këtë këndvështrim e shikoj unë edhe qëndrimin ndaj stabilitetit dhe kurrësesi si një kapërcim ndaj një portofoli apo mandati të caktuar. Pikërisht kjo është dhe arsyeja që fjalët e mikut të Shqipërisë, Presidentit aktual të Bashkimit Europian, Romano Prodi, në Tiranë, një javë më parë, u kuptuan aq lehtë dhe përsëriten edhe sot nga të gjithë qytetarët shqiptarë: "Nëse do të ruajë stabilitetin, Shqipëria do të bëjë mrekullira".